

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani anëtarë, në çështjen juridike të paditësve S. H., dhe B. H., nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Xh. B., nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K. e R.”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N.B., me autorizim, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e së paditurës dhe të paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1445/2016 datë 25.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.11.2016, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pathemeltë revizioni i së paditurës dhe i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1445/2016 dt.25.07.2016.

### A r s y e t i m i

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1061/14 dt.20.01.2016, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve, detyrohet e paditura që për shkak të dëmit të pësuar nga aksidenti i komunikacionit të ndodhur me dt.31.07.2014, paditësit S. H., në emër të kompensimit të dëmit jo material, për dhimbje fizike t'i paguajë shumën prej 10.000€, për frikë 4000€, për shëmtim trupor 10.000€, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor(65%) shumën prej 40.000€ dhe për dëm material, për ushqim të përforcuar shumën prej 600€, për kujdesin e huaj 600€, për rehabilitim 1000€, për shpenzime të mjekimit 13.033€. Ndërsa, detyrohet e paditura, që paditësit të dytë, B. H., në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike t'i paguajë shumën prej 1000€, për shëmtim trupor 2000€, për frikë 1000€ dhe për dëm material, për ndihmën e huaj 100€, ushqim të përforcuar 200€, rehabilitim fizioterapeutik 150€, të gjitha me kamatë ligjore duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit deri në pagesën përfundimtare si dhe e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguajë pjesërisht shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.253,00€, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ,me kërcënim përmbarimi.

Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve,përtej shumave të gjykuara,e ka refuzuar si të pabazuar.

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1445/16 dt.25.07.2016,ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë C.nr.1061/14 dt.20.01.2016,në pikën II të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit, për paditësin e parë S. H., ashtu që detyrohet e paditura që paditësit të parë t'i kompensojë për dhimbjet fizike shumë prej 5000€ dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 26.000€, kurse, sa i përket kompensimit të dëmit lidhur me shëmtimin trupor të paditësit S. H., në këtë pjesë e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, ndërsa, lidhur me pjesën tjetër të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ankesat e paraqitura i ka refuzuar si të pathemelta dhe të njëjtin aktgjykim e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë,(pjesës aprovuese)në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulta të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim,në gjykatën e shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë(pjesës ndryshuese)në afat ligjor, ka paraqitur revizion edhe pala paditëse, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet revizioni, të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë, në lidhje me kompensimin e dëmit për paditësin e parë,për dhimbje fizike dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjishëm jetësor, ndërsa, në këtë pjesë, të lëhet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i së paditurës dhe i paditësve është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës (raporti i policisë,raportet mjekësore, ekspertizat mjekësore, ekspertiza e komunikacionit, etj) rezulton se aksidenti i komunikacionit kishte ndodhur me datën 31.07.2014, në autostradë, në afërsi të fsh...,kur ngasësi i automjetit Opel Kadet, i siguruar ke e paditura, për shkak të pakujdesisë dhe duke mos respektuar distancën e sigurisë së automjetit dhe

duke mos i përshtatur kushteve dhe rrethanave të rrugës ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit (në mënyrën e përshkruar në raportin e policisë, përkatësisht, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit). Në këtë aksident, paditësi S. H., (në cilësi të bashkudhëtarit) ka pësuar lëndime të rënda trupore, me pasoja të përhershme, në kokë dhe fytyrë, me thyerje të shumëfishtë të kockave, thyerje të kofshës së kockës së djathtë, thyerje të pjesës së poshtme të parakrahut të djathtë, thyerje të zgjatimeve anësore të unazave LD2,L3 dhe L5 si dhe thyerje të brinjëve 3 dhe 4 djathtas. Për këto lëndime ai është operuar dhe i është bërë fiksimi i kockës me fiksues të jashtëm dhe të brendshëm. Nga ekspertizat mjekësore rezulton se aktiviteti i përgjithshëm jetësor i është zvogëluar në shkallën prej 65%, ka patur shëmtim trupor të shkallës së mesme, ka patur nevojë për ushqim të përforcuar një vjet, ndihmën e huaj tetë muaj (ka patur në këtë kohë dëmtime fokale të trurit), pamundësisë së lëvizjes për shkak të dëmtimit të kurrizit, rehabilitim 30 ditë, dhe shpenzime të konsiderueshme lidhur me mjekimin, në Spitalin Amerikan në Tiranë,(faturat nga f.1 deri 91).Në momentin e aksidentit, kishte humbur vetëdijen, ishte dërguar në QKUK-Prishtinë, ka patur dhimbje të intensitetit të rënd 7 ditë, të intensitetit të mesëm 2 muaj,të ulët edhe sot e kësaj dite. Frikë primare nuk ka mundur të përjetojë për shkak të humbjes së vetëdijes, ka patur frikë sekondare të intensitetit të lartë një javë e shfaqur pas kthimit të vetëdijes, të intensitetit të ulët e cila është ende prezentë, në formë të prishjes së gjumit, nervozizmit, lodhjes, koke dhimbjes, vështirësisë në koncentrim, në procesimin e informacionit, shpërthime emocionale. Kurse, paditësit të dytë nga aksidenti i komunikacionit i janë shkaktuar plagë prerëse në regjionin temporal të kokës, ndrydhje në regjionin e mollëzës së fytyrës së djathtë, plagë prerëse ndërmirëse në pjesën e pasme të parakrahut të djathtë dhe ndrydhje e shpatullës së djathtë dhe gjithë trupit. Këto lëndime tek ky janë cilësuar si lëndime të lehta trupore, të cilat kanë shkaktuar dhimbje trupore të intensitetit posaqë rishte të rënd për një orë, sa është dashtë të merret ndihma parë, dhimbje të intensitetit të rënd 24 orë, të mesëm 10 ditë, të ulët edhe sot e kësaj dite, shëmtim trupor të shkallës së mesme, për ndihmën e huaj ka patur nevojë 10 dite, ushqim të përforcuar 21 ditë, dhe shërim klimatik 10 ditë. Ka patur frikë primare 2-3 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, të ulët 1 vit(të përshkruara këto, detajishtë në ekspertizat mjekësore).E paditura edhe pse pjesërisht e ka kontestuar bazën juridike të padisë, megjithatë në seancën e fundit gjyqësore ka ofruar paditësve kompensimin dhe ate për paditësin e parë në shumë prej 25.000-euro dhe për paditësin e dytë 2500-euro(procesverbali i dt.20.01.2016).

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesë-padinë e paditësve dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e sipër theksuar të aktgjykimit të sajë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në kuptimin e më sipërme, ndaj, aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të karakterit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së parë (pjesa vërtetuese) dhe nga Gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar) përkitazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material, drejtë është aplikuar dispozita e nenit 169 dhe nenit 183 të LMD-ës në lidhje me nenin 323 të LPK-ës, duke patur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve përkatës mjekësor lidhur me lëndimet e pësuar trupore dhe pasojat e përhershme për paditësin e parë, natyrën, peshën, intensitetin e dhimbjeve, frikës, shkallën e shëmtimit trupor, (shkalla mesme) të paditësve, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit të parë (65 %). Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfakcion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 183 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror, prandaj, duke patur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartëcekur, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Gjykata e instancës më të ulët, me rastin e vendosjes për llojet dhe shumat e kompensimit të dëmit jo material të paditësve, ka patur parasysh konstatimet që u sipër theksuan më lartë, e veçanërisht, përkitazi me paditësin e parë S. H., faktin se ai është i moshës relativisht të re, pra, moshën e tij, shkallën e zvogëlimit të

aktivitetit të përgjithshëm jetësor të tij(65%),lëndimet e shumta trupore dhe të rënda me pasoja të përhershme, shëmtimit trupor të tij,(shkalla mesme)me manifestim të sipër përshkruar të pasojave të konstatuara nga ekspertizat mjekësore.

Prandaj, nga këtu nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit të palës paditëse dhe të palës së paditur lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara, sikundër që janë të pathemelta thëniet e revizionit të së paditurës lidhur me kontributin dhe përgjegjësinë e ndarë të paditësve në aksidentin e ndodhur me dt.31.7.2014,ekspertizës së ekspertit të komunikacionit, mjekimit dhe shpenzimeve të mjekimit në Spitalin Amerikan në Tiranë (dhe jo në Prishtinë),etj,kjo për faktin sepse, shumat e gjykuara janë reale, adekuate dhe në korrelacion me llojin, peshën, natyrën, pasojat e lëndimeve trupore të pësura të paditësve(të sipër theksuara)dhe në mbështetje të të gjitha ekspertizave mjekësore të kryera(ndërkohë që, ekspertët mjekësor kishin theksuar se ai, paditësi i parë, për shkak të lëndimeve të rënda që ka pësuar...,nuk mund të trajtohet në QKUK-Prishtinë-f.5 e procesverbalit të dt.4.12.2015). Matej, do theksuar faktin se nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit, rezulton kuartë se deri ke aksidenti i komunikacionit ka ardhur me lëshimet e të siguruarit të së paditurës(shih ekspertizën)dhe në këtë kontekst, duhet veçuar faktin se përfaqësuesi i së paditurës, në zhvillimin e provës, me leximin e mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit nuk ka patur vërejtje, nuk e ka kontestuar(shih procesverbalin e seancës gjyqësore dt.29.10.2015-f.3),madje, më pas, edhe kishin bërë ofertën e vet të kompensimit të dëmit, që t'i paguajnë dhe ate paditësit të parë 25000€,paditësit të dytë 2500€ (procesverbali nga seanca dt.20.01.2016).

Për arësyet e sipërpërmendura, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.279/2016 datë 18. 11. 2016

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha